



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR



KËSHILLI BASHKIAK



“ PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027 DHE BUXHETIT VJETOR 2025”

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 12.12.2024 pasi shqyrtoi materialin e relatuar nga Kryetari i Bashkisë “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025”. Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr 10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 23/2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm në njëtitë e pushtetit vendor” i ndryshuar, Udhëzimit nr 3, datë 28.02.2024 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027”, Udhëzimit nr 8, datë 05.07.2024 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027”, si dhe në mbështetje të VKB nr 106, datë 14.12.2022 “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit vjetor 2025”, VKB nr 08, datë 31.01.2024 “Për miratimin e raportit të vlerësimit të të ardhura afatmesme 2025-2027”, VKB nr 18, datë 29.03.2024 “Për miratimin e tavanëve përgatitore buxhetore në nivel programi për PBA 2025-2027 në Bashkinë Gjirokastrë”, VKB nr 50, datë 31.07.2024 “Për miratimin e tavanëve të rishikuara përgatitore buxhetore në nivel programi për PBA 2025-2027 në Bashkinë Gjirokastrë”.

VENDOSI:

1. Të miratojë programin buxhetor afatmesëm 2025-2027 sipas dokumentit bashkëngjitur.
2. Të miratojë buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë për vitin 2025 sipas përcaktimit të nentit 40, të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
3. Të miratojë treguesit e buxhetit 2025 si më poshtë :

I

A- Të ardhura gjithsej.....	1,038,670,209
A.1 Të ardhurat e veta të planifikuara për 2025.....	270,781,000
B- Transferta gjithsej.....	626,744,209

B.4 Grante të huaja.....31,145,000

II

A- Shpenzime personeli..... 645,914,000

B- Shpenzime mallra dhe shërbime.....209,470,000

C- Shpenzime kapitale.....183,286,209

4. Për kompetencë të kryetarit të bashkisë

a) Rishpërndarja e projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program.

b) Rishpërndarja ndërmjet zërave të shpenzimeve koherente, brenda të njëjtit program.

c) Përdorimi i fondit të veçant sipas legjislacionit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Merita ISARAJ



Sekretar i Këshillit

Etleva Yzo

A handwritten signature in black ink, appearing to be "Etleva Yzo", written over a horizontal line.